

**KODI I ETIKËS**  
**PËR**  
**GJYQTARËT E GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Preambul**

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, duke qenë të vetëdijshëm se detyra e gjyqtarit të kësaj Gjykate është funksion publik i një rëndësie parësore për mbrojtjen e kushtetutshmërisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut, si dhe duke pasur parasysh kriteret dhe garancitë kushtetuese e ligjore që duhet të plotësojë gjyqtari për ushtrimin e funksionit të tij, me synim rritjen dhe forcimin e besimit të publikut ndaj vendimmarrjes së tyre, miratojnë këto parime e standarde për të udhëzuar dhe drejtuar sjelljen e tyre në ushtrimin e përgjegjësisë.

**Neni 1**

**Qëllimi**

Kodi synon të drejtojë sjelljen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese (këtu e në vijim gjyqtari/Gjykata) në përputhje me standardet më të larta etike e profesionale dhe me interesin publik, që imponon përgjegjësia e detyrës që mban, duke ofruar udhëzimet e nevojshme për të ruajtur dhe forcuar besimin e publikut në pavarësinë dhe në paanshmërinë e Gjykatës.

**Neni 2**

**Objekti**

Ky Kod përcakton parimet dhe standardet që drejtojnë gjyqtarin e Gjykatës gjatë ushtrimit të detyrës dhe në veprimtaritë e marrëdhëniet jashtë saj, dhe, sipas rastit, gjyqtarin pas largimit nga detyra.

**I. Gjatë ushtrimit të detyrës**

**Neni 3**

**Pavarësia**

Në ushtrimin e funksioneve të tij kushtetuese gjyqtari duhet të jetë besnik ndaj Kushtetutës dhe të mbetet i pavarur nga çdo autoritet ose ndikim i jashtëm i papërshtatshëm. Ai duhet të shmangë çdo situatë dhe të vetëkufizohet nga çdo veprimtari ose anëtarësim në çfarëdo organizatë apo pjesëmarrjeje në forume, që mund të ndikojë në besimin e publikut në pavarësinë e tij.

## **Neni 4**

### **Paanshmëria**

Gjyqtari e ushtron detyrën e tij me vendosmëri, maturi dhe në mënyrë të paanshme, duke marrë masa që kjo paanshmëri të jetë e qartë për publikun në çdo veprim. Ai kujdeset që të parandalojë çdo situatë që krijon konflikt interesi të mundshëm në vendimmarrjet e tij ose që mund të perceptohet se shkakton konflikt interesi nga një këndvështrim i arsyeshëm.

## **Neni 5**

### **Integriteti**

Sjellja e gjyqtarit duhet të jetë në përputhje me karakterin e lartë moral dhe integritetin profesional, si kërkesë kryesore për funksionin gjyqësor. Ai duhet të jetë i vetëdijshëm në çdo kohë për detyrën e tij për të mbështetur pozitën dhe autoritetin e Gjykatës.

## **Neni 6**

### **Liria e shprehjes**

Gjyqtari e ushtron lirinë e shprehjes në pajtim me dinjitetin e detyrës. Ai duhet të shmangë deklaratat publike ose reagimet, që mund të cenojnë autoritetin e Gjykatës ose të shkaktojnë dyshime të arsyeshme për paanshmërinë e tij, në çdo lloj medie elektronike apo të shkruar.

Gjyqtari tregon vetëpërmbytje në reagimin ndaj kritikave ose opinioneve të shprehura për qëndrimet dhe veprimtarinë e tij profesionale.

## **Neni 7**

### **Parimi i barazisë**

Gjyqtari e ushtron veprimtarinë e tij pa favorizuar ose paragjykuar asnjë palë apo çështje. Ai shmang çdo shfaqje, me veprime ose mosveprime, sjellje ose shprehje që krijojnë dyshimin për trajtim të pabarabartë e të pajustificuar nga motive ligjore.

## **Neni 8**

### **Respektimi i dinjitetit në proces**

Gjyqtari gjatë ushtrimit të detyrës respekton dinjitetin njerëzor të subjekteve dhe palëve të përfshira në proces.

Gjyqtari e ushtron vendimmarrjen duke reflektuar ndjeshmëri ndaj situatave të palëve dhe atyre që lidhen me procesin.

## **Neni 9**

### **Kompetencat dhe aftësitë profesionale**

Gjyqtari gjatë shqyrtimit të çështjeve i kryen detyrat e tij me kompetencë profesionale, maturi e shpejtësi.

Për të ruajtur një nivel të lartë të kompetencës, ai kujdeset në vazhdimësi për zhvillimin e aftësive të tij profesionale dhe për informimin me zhvillimet e së drejtës kushtetuese dhe jurisprudencës përkatëse, vendase, rajonale dhe ndërkombëtare, veçanërisht me ato në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut.

## **Neni 10**

### **Konfidencialiteti**

Gjyqtari ruan dhe garanton konfidencialitetin e informacioneve të klasifikuara dhe të të dhënave personale, me të cilat është njohur gjatë ushtrimit të funksionit të tij në procedurat e zhvilluara në Gjykatë, të mbrojtura nga ligji.

Gjyqtari respekton konfidencialitetin e diskutimeve të zhvilluara gjatë veprimtarisë në Gjykatë.

Gjyqtari nuk shpreh qëndrime publike në lidhje me çështjet që janë në proces shqyrtimi në Gjykatë dhe për të cilat nuk është marrë vendim.

## **Neni 11**

### **Sjellja në Gjykatë**

Gjyqtari duhet t'i drejtohet në mënyrë etike dhe profesionale çdo punonjësi të Gjykatës dhe duhet të sigurojë, nëpërmjet shembullit, që sjellja e tij të jetë në përputhje me standardet etike dhe profesionale.

## **Neni 12**

### **Mbarëvajtja e institucionit**

Gjyqtari angazhohet në vijimësi për mbarëvajtjen institucionale të Gjykatës.

## **Neni 13**

### **Administrimi dhe burimet e Gjykatës**

Gjyqtari tregon kujdes për administrimin dhe shfrytëzimin e burimeve financiare dhe materiale të Gjykatës në mënyrë efektive dhe vetëm për qëllime që lidhen me ushtrimin e detyrës.

## **II. Veprimtaritë dhe marrëdhëniet jashtë detyrës gjyqësore**

### **Neni 14**

#### **Veprimtaritë e jashtme**

Gjyqtari nuk mund të angazhohet në veprimtari jashtëgjyqësore, të cilat bien ndesh me detyrën e tij dhe cenojnë dinjitetin e tij profesional, si dhe autoritetin e Gjykatës.

Gjyqtari mund të angazhohet në veprimtari mësimdhënëse, akademike dhe shkencore për aq kohë sa ky angazhim nuk pengon dhe nuk cenon ushtrimin e detyrës në përputhje me parimet e këtij Kodi. Në çdo rast, gjyqtari vë në dijeni Kryetarin e Gjykatës për angazhimin konkret.

Gjyqtari mund të angazhohet në organizma, vendase ose ndërkombëtare, të krijuara për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e gjyqtarëve.

### **Neni 15**

#### **Dhuratat dhe trajtimi preferencial**

Gjyqtari nuk duhet të pranojë asnjë dhuratë, trajtim preferencial ose përfitim të çfarëdo natyre që cenon ose vë në dyshim pavarësinë dhe paanshmërinë e tij në ushtrimin e detyrës apo bie në kundërshtim me legjislacionin përkatës.

### **Neni 16**

#### **Pagesat për fjalimet dhe botimet**

Gjyqtari nuk duhet të pranojë asnjë formë pagese për fjalimet, komentet ose botimet që lidhen drejtpërdrejt me përgjegjësitë e tij në ushtrimin e detyrës apo është në kundërshtim me legjislacionin përkatës.

## **III. Kufizime pas largimit nga detyra**

### **Neni 17**

#### **Ruajtja e konfidencialitetit**

Gjyqtari pas largimit nga detyra duhet të veprojë në përputhje me parimet e këtij Kodi, sipas rastit, kur vlerëson se kjo kërkohet nga mandati si anëtar i mëparshëm i Gjykatës.

Gjyqtari pas largimit nga detyra ruan dhe garanton konfidencialitetin e informacioneve të klasifikuara dhe të të dhënave personale, me të cilat është njohur gjatë ushtrimit të funksionit të tij.

**Neni 18**  
**Përfaqësimi në Gjykatë**

Gjyqtari i cili është larguar nga detyra tregon vetëpërmbytje në përfaqësimin përpara Gjykatës të çështjeve me të cilat është njohur në cilësinë e gjyqtarit gjatë ushtrimit të funksionit dhe nuk shpreh qëndrime publike në lidhje me to.

**IV. Të fundit**

**Neni 19**  
**Këshillimi**

Kur një gjyqtar nuk është i sigurt për sa i përket kuptimit dhe detyrimeve që rrjedhin nga parimet e standardet e përcaktuara në këtë Kod, ai mund të konsultohet me Kryetarin e Gjykatës.

Mbledhja e Gjyqtarëve mund të caktojë një nga gjyqtarët për të ndjekur zbatimin e këtij Kodi, si dhe për të shtruar çështje që duhet të diskutohen në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe për të cilat duhet të mbahet qëndrim.

**Neni 20**  
**Kodi dhe legjislacioni përkatës**

Ky Kod nuk zëvendëson dhe nuk konkurren me rregullat etike për shmangien e konfliktit të interesit dhe masat disiplinore, të përcaktuara në ligjin organik të Gjykatës dhe në aktet e tjera ligjore përkatëse në fuqi.

**Neni 21**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Kod hyn në fuqi menjëherë dhe bëhet publik përmes Programit të Transparencës së Gjykatës.